



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**RREGULLORE (QRK) NR. 25 /2024 PËR RREGULLAT E PËRBËRJES SË
ORGANIT KOLEGJIAL NË PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË
ANKESËS ADMINISTRATIVE NDAJ VENDIMIT PËRFUNDIMTAR TË
INSPEKTIMIT¹**

¹ Rregullore (QRK) Nr. 25/2024 për Rregullat e Përbërjes së Organit Kolegjial në Procedurën e Shqyrtimit të Ankesës Administrative ndaj Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, është miratuar në mbledhjen e 220-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/220, të datës 11.09.2024

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8, paragrafit 4, nënparagrafi 4.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49, paragrafit 4 të Ligjit Nr.08/L-067 për Inspektimet,

miraton:

RREGULLORE (QRK) NR. 25/2024 PËR RREGULLAT E PËRBËRJES SË ORGANIT KOLEGJIAL NË PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË ANKESËS ADMINISTRATIVE NDAJ VENDIMIT PËRFUNDIMTAR TË INSPEKTIMIT

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të përbërjes, kualifikimeve dhe procedurës së emërimit të anëtarëve të organit kolegjal në procedurën e shqyrtimit të ankesës administrative ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për krijimin e organeve kolegjiale në cilësinë e organit epror për zhvillimin e procedurës së ankesave ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në pajtim me ligjin përkatës për inspektimet dhe ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet ndaj:

- 2.1. inspektimit doganor dhe tatimor;
- 2.2. inspektimit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- 2.3. inspektimit të brendshëm me karakter administrativ në administratën shtetërore dhe komunale;

2.4. inspektimeve nga Inspektorati Policor;

2.5. inspektimeve për siguri publike në kuadër të ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **Organ kolegjal** – nënkupton organin epror në procedurë administrative, gjegjësisht Komisionin e Ankesave ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit.

2. Termat tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin përkatës për inspektimet dhe ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

KAPITULLI II

PËRBËRJA, KUALIFIKIMET DHE PROCEDURA E EMËRIMIT TË ANËTARËVE TË ORGANEVE KOLEGJIALE

Neni 4

Organet Kolegjiale

1. Organet kolegjiale (tani e tutje: Komisionet e Ankesave) janë organe eprore në procedurën e shqyrtimit të ankesave administrative për procedurat e inspektimit, të cilat krijohen në pajtim me ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative në rastet e:

1.1 inspektorateve qendrore;

1.2.inspektorateve komunale;

1.3.njësive të veçanta të inspektimit në kuadër të ministrive;

1.4.njësive të veçanta të inspektimit në kuadër të agjencive ekzekutive;

1.5.njësive të veçanta të inspektimit në kuadër të agjencive rregullatore.

Neni 5

Përbërja e Komisionit të Ankesave në rastin e inspektorateve qendrore

1. Komisioni i Ankesave tek inspektoratet qendrore përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët janë nëpunës civilë, nga të cilët njëri është jurist, dhe të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - 1.1. të kenë së paku 240 ECTS ose titullin master;
 - 1.2. të kenë të paktën tre (3) vjet përvojë pune në fushën përkatëse.
2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, njëri nga anëtarët është nga njësi organizative e ministrisë e cila është përgjegjëse dhe mbulon politikbërjen e fushës ku kryhet inspektimi.
3. Pjesë e Komisionit të Ankesave nuk mund të jenë nëpunësit civilë të inspektorateve qendrore.
4. Njësia për burime njerëzore bën verifikimin e kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1, 2 dhe 3 dhe krijon listën e kandidatëve që plotësojnë këto kritere dhe i propozon për emërim tek ministri i Ministrisë ku bën pjesë inspektorati përkatës.
5. Anëtarët e Komisionit të Ankesave sipas këtij neni emërohen me vendim të ministrit me mandat tre (3) vjeçar.

Neni 6

Përbërja e Komisionit të Ankesave në rastin e inspektorateve komunale

1. Komisioni i Ankesave tek inspektoratet komunale përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët janë nëpunës civilë, nga të cilët njëri është jurist, dhe të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - 1.1. të kenë së paku 240 ECTS ose titullin master;
 - 1.2. të kenë të paktën tre (3) vjet përvojë pune në fushën përkatëse.
2. Pjesë e Komisionit të Ankesave nuk mund të jenë nëpunësit civilë të inspektorateve komunale.
3. Njësia për burime njerëzore bën verifikimin e kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 dhe krijon listën e kandidatëve që plotësojnë këto kritere dhe i propozon për emërim tek kryetari i Komunës përkatëse.

4. Anëtarët e Komisionit të Ankesave sipas këtij neni emërohen me vendim nga kryetari i Komunës me mandat tre (3) vjeçar.

Neni 7

Përbërja e Komisionit të Ankesave në rastin e njësive të veçanta të inspektimit në kuadër të ministrive

1. Komisioni i Ankesave tek njësitë e veçanta të inspektimit në kuadër të ministrive përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët janë nëpunës civilë, nga të cilët njëri është jurist dhe të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1.1. të kenë së paku 240 ECTS ose titullin master;

1.2. të kenë të paktën tre (3) vjet përvojë pune në fushën përkatëse.

2. Njëri nga anëtarët është nga njësia organizative e ministrisë e cila është përgjegjëse dhe mbulon politikbërjen e fushës ku kryhet inspektimi.

3. Pjesë e Komisionit të Ankesave nuk mund të jenë nëpunësit civilë të njësive të veçanta të inspektimit në kuadër të ministrive.

4. Njësia për burime njerëzore bën verifikimin e kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1, 2 dhe 3 dhe krijon listën e kandidatëve që plotësojnë këto kritere dhe i propozon për emërim tek ministri i Ministrisë ku bën pjesë njësia e veçantë e inspektimit.

5. Anëtarët e Komisionit të Ankesave sipas këtij neni emërohen me vendim nga ministri me mandat tre (3) vjeçar.

Neni 8

Përbërja e Komisionit të Ankesave në rastin e njësive të veçanta të inspektimit në kuadër të agjencive ekzekutive

1. Komisioni i Ankesave tek njësitë e veçanta të inspektimit në kuadër të agjencive ekzekutive përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët janë nëpunës civilë, nga të cilët njëri është jurist dhe të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1.1. të kenë së paku 240 ECTS ose titullin master;

1.2. të kenë të paktën tre (3) vjet përvojë pune në fushën përkatëse.

2. Njëri nga anëtarët është nga njësia organizative e agjencisë ekzekutive e cila është përgjegjëse dhe mbulon fushën ku kryhet inspektimi.
3. Pjesë e Komisionit të Ankesave nuk mund të jenë nëpunësit civilë të njësive të veçanta të inspektimit në kuadër të agjencive ekzekutive.
4. Njësia për burime njerëzore bën verifikimin e kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1, 2 dhe 3 dhe krijon listën e kandidatëve që plotësojnë këto kriterë dhe i propozon për emërim tek titullari i agjencisë përkatëse.
5. Anëtarët e Komisionit të Ankesave sipas këtij neni emërohen me vendim nga titullari i agjencisë përkatëse me mandat tre (3) vjeçar.

Neni 9

Përbërja e Komisionit të Ankesave në rastin e njësive të veçanta të inspektimit në kuadër të një agjencie rregullatore

1. Komisioni i Ankesave tek njësitë e veçanta të inspektimit në kuadër të një agjencie rregullatore përbëhet nga drejtuesi apo organi drejtues i agjencisë rregullatore, përveçse kur përcaktohet shprehimisht ndryshe me ligj të posaçëm.
2. Në rastet kur agjencia rregullatore udhëhiqet nga drejtuesi, atëherë drejtuesi ka kompetencën ekskluzive të Komisionit të Ankesave.
3. Në rastet kur agjencia rregullatore udhëhiqet nga organi drejtues, atëherë organi drejtues është organi epror përkatësisht organi kolegjal që shqyrton ankesat që paraqiten kundër vendimeve përfundimtare të njësive të veçanta të inspektimit.

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 10 Dispozitat Kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, procedurat e ankimimit të cilat janë në shqyrtim do të vazhdojnë të shqyrtohen nga komisionet përkatëse të ankesave, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj të posaçëm.
2. Procedurat e ankimimit të cilat shqyrtohen nga komisionet e ankesave dhe fillojnë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pranohen, shqyrtohen dhe vendosen sipas rregullave të përcaktuara për përbërjen e komisioneve të ankesave të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

13 shtator 2024